



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 79/2012
Prishtinë, më 17.10.2012, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha-Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi. Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Fikrim Damka, Berat Buzhala dhe Visar Ymeri.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi –ZPRK; Imer Hamiti- IKPZH; Visar Rushiti-GAP; Burim Ejupi- INDEP; Nevahir Haziri dhe Gëzim Prapashtica – KDI dhe Flamur Hyseni –NDI

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur 02.10.2012;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-159 për Zonat ekonomike;
4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin Nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme;
5. Njoftimi i Komisionit me shkresën e KPU Inspekt;
6. Te ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 02.10.2012

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 02.10. 2012 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi ne parim i Projektligjit Nr. 04/L-159 për Zonat ekonomike

Kryetari - Hapi debat në parim në lidhje me këtë projektligj të proceduar nga Qeveria dhe propozoi që të formohet një grup i punës. Sipas Rregullores së Kuvendit, ky grup i punës ta shqyrtojë Projektligjin dhe, pastaj t'i nxjerrë propozim-amendamentet për shqyrtim në mbledhje të Komisionit.

Pas debatit, Komisioni unanimitet nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-159 për Zonat ekonomike.

Kuvendit vendosi që t'ia paraqet këtë

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligj Nr. 04/L-159 për Zonat ekonomike.

Po ashtu, Komisioni unanimitet nxori këtë

V E N D I M

- 1. Formohet Grupi punues për shqyrtimin e Projektligji Nr. 04/L-159 për Zonat ekonomike;*
- 2. Grupi punues ka këtë përbërje: Zenun Pajaziti, raportues, Sala Berisha – Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi dhe Biserka Kostiq anëtarë;*
- 3. Secili anëtar i Komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjitet Grupit punues gjatë punës së tij;*
- 4. Grupi punues në bashkëpunim me Njësinë koordinuese të Komisionit të hartojë Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin më shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin Nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme

Kryetari -I njoftoi deputetet se Komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Raportin me amendamente dhe nuk kanë pasur ndonjë vërejtje. Prandaj, sipas procedurës së rregullt, raportin me Rekomandime për Projektligjin Nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme, duhet ta procedojmë për seancë plenare për lexim të dytë.

Pas debatit Komisioni unanimitet nxori këtë

Rekomandim

- I. *I rekomandohet Kuvendit miratimi i Projektligjit Nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL;*

5. Njoftimi i Komisionit me shkresën e KPU Inspekt

Kryetari – Tha se këtë njoftim të KPU Inspekt e ka dërguar Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, ku e kanë shpallur komisionin e tyre si jo kompetent, më arsyetimin se për këtë çështje është Komisionit FunkSIONAL për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri. Propozoi që kjo shkresë të diskutohet në takimet e radhës që do t'i këtë Komisionin më Ministren e Tregtisë dhe Industrisë, së ku qëndron ky problem lidhur më këtë shkresë.

Lutfi Zharku - Tha se për këtë çështje, në kuadër të MTI- së në bazë të Ligjit, është i themeluar organi kompetent që merret më licencimin e kompanive për cilësinë e karburanteve të naftës, prandaj për këtë çështje ekzistojnë procedura ligjore për ankesa që mund t'i drejtohen edhe gjykatave kompetente.

Ramiz Kelmendi - Tha se këto në shkresë po shihet që kanë qenë dy kompani për licencim dhe MTI- ja, duhet ta formojë një komisioni që ta bëjë rivlerësimin e vendimit dhe të këtë kujdes në gjatë nxjerrjes së vendimeve për cilësinë së naftës.

Sala Berisha –Shala - Propozoi që për këtë çështje mund t'i ftojnë dhe përfaqësuesit përkatës të MTI-së që të njoftojnë më në detaje së ku qëndron problemi.

Hashim Deshishku – Theksoi se disa veprime nga MTI-ja që nuk kanë bazë ligjore dhe për këtë shkresë duhet të ftohen për raportim në Komision për të na njoftuar më hollësisht për cilësinë e importuar të derivateve të naftës.

Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë

Konkluzion

- 1. Në mbledhjen e radhës së të debatohet në lidhje me zbatimin e Ligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, respektivisht për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës;*
- 2. Të ftohen për raportim në Komision, zyrtaret përgjegjës në lidhje më këtë çështje.*

6. Të ndryshme Çështje vijuese;

Sala Berisha – Shala - I njoftoi anëtarët e Komisioni se grupi punues për monitorimin e Ligjit për eficienten e energjisë, i ka mbajtur dy takime deri më tani, dhe i ftoi deputetet e tjerë që mund të marrin pjesë në takime e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit